



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I DREJTËSISË
INSPEKTORATI**

TIRANË, 24 MARS 2014

RAPORT VJETOR

MBI

VEPRIMTARINË E INSPEKTORATIT

TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

PËR VITIN KALENDARIK 2013

Përgatitur nga:

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë
Kryeinspektore Marsida Xhaferllari

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (IKLD) është një strukturë shtetërore, e ngritur me ligj në vitin 1999, që funksionon në varësi të drejtpërdrejtë të KLD-së. Me ligj, IKLD-së i është ngarkuar përgjegjësia e monitorimit të performancës së sistemit gjyqësor nëpërmjet ushtrimit të inspektimeve, verifikimit të ankesave dhe vlerësimit të aftësive profesionale të gjyqtarëve. Veprimtaria e IKLD-së i shërben KLD-së për të ushtruar funksionet kushtetuese të kontrollit dhe të rritjes në karrierë të gjyqtarëve. Organizimi dhe funksionimi i tij rregullohet përmes dy ligjeve organike mbi pushtetin gjyqësor dhe mbi KLD-në.

IKLD, nëpërmjet Kryeinspektore, paraqet këtë raport vjetor me shkrim pranë KLD-së bazuar në nenin 55 të Rregullores së IKLD-së. Ky raport përmban të dhëna mbi veprimtarinë e IKLD-së në vitin kalendarik 2013 dhe në të gjejnë pasqyrim problematikat e trajtuara dhe rezultatet e punës.

Në të përshkruhet gjendja e burimeve njerëzore dhe statusi i inspektorëve, për të vijuar me masën e realizimit të detyrave funksionale, siç janë verifikimi i ankesave, inspektimet tematike, vlerësimi profesional dhe etik i gjyqtarëve, përpunimi i informacionit periodik të gjykatave dhe i vendimeve të cenuara, përpunimi i kërkesave për delegim të gjyqtarëve, përfaqësimi në gjykatë në çështjet gjyqësore deri tek marrëdhëniet institucionale me organet e treta.

Paraqitja e këtij Raporti i shërben jo vetëm analizës së gjendjes aktuale të IKLD-së, por edhe përcaktimit të prioriteteve të veprimtarisë së tij në drejtim të efikasitetit dhe profesionalizmit në detyrë.

II. VERIFIKIMI I ANKESAVE

Një nga përgjegjësitë më të rëndësishme të Inspektoriatit është verifikimi i ankesave, të cilat mund të paraqiten nga qytetarët ose çdo subjekt i interesuar. Rregullat e brendshme vendosin si kusht të domosdoshëm paraqitjen e një ankesë formale me shkrim, e cila duhet të plotësojë disa elementë të domosdoshëm. Në këtë mënyrë, Inspektorati nuk vepron dot me nismën e tij kur ankesat paraqiten publikisht në forume diskutimi apo kur bëhen prezente nga mjetet masive të medias.

Rezultatet e këtyre ankesave i nënshtrohen vlerësimit paraprak, i cili mund të konkludojë me arkivimin e ankesës nëse shkaqet janë haptazi të pabazuara ose me verifikimin në terren të ankesës, nëse ka dyshime për shkelje ligjore formale. Aktualisht, rregullat janë të paqarta mbi burimin e sigurimit të provave/të dhënave në fazën e vlerësimit paraprak, si dhe në fazën e verifikimit në themel të ankesës. Gjithashtu, rregullat për arkivimin e ankesës mbi një shqyrtim *prima facia* nga Inspektorati janë të paplota dhe për pasojë inspektorët shpesh janë në pamundësi për të identifikuar saktë konkluzionet në fazën e vlerësimit paraprak.

Nëse gjatë verifikimit në terren të ankesave, Inspektorati konstaton shkelje në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarëve, atëherë ka bazë për zhvillimin e dy procedurave. Nëse shkeljet janë të lehta dhe të papërshtatshme për fillimin e një procedimi disiplinor, gjyqtarit i regjistrohen të dhënat për vlerësimin profesional ose i tërhiqet vëmendja me shkrim për to. Nëse shkeljet janë të afta për të filluar një procedim disiplinor, atëherë të gjitha materialet i dërgohen zyrtarisht Ministrisë të Drejtësisë, që ai të vlerësojë mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor të gjyqtarëve.

Aktualisht, procesi i verifikimit ka mangësi në drejtim të standardeve të procesit të rregullt ligjor. Midis Inspektoriatit dhe gjyqtarit të verifikuar nuk ndërtohet deri në fund një proces njohjeje dhe komunikimi i ndërsjellë mbi gjetjet e verifikimit. Gjyqtari merr njoftim mbi shkeljet e konstatuara vetëm me njoftimin e tërheqjes së vëmendjes ose vetëm me njoftimin e Ministrisë të Drejtësisë. Në këtë pikëpamje, gjyqtari nuk ka mundësi të prapësojë gjetjet e inspektimit.

Nga ana tjetër, rregullat e Inspektoriatit janë miratuar në vitin 2006 dhe nuk janë harmonizuar me ndryshimet e vitit 2008 mbi organizimin e pushtetit gjyqësor. Ligji i vitit 2008, bazuar në parimin e ligjshmërisë ka përcaktuar hipoteza të shprehura për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarit, të cilat mungojnë në rregullore. Këto hipoteza lidhen me shkeljen e qëllimshme ose shkeljen e përsëritur të dispozitave urdhëruese procedurale nga ana e gjyqtarit. Në disa raste ka edhe mospërputhje të hipotezave përgjegjësi disiplinore me kufijtë e veprimit nga Inspektorati, siç është rasti i mosbërjes së kërkesës së gjyqtarit për përjashtim nga një çështje konkrete.

Përmirësimi i rregullave të verifikimit të ankesave është me rëndësi thelbësore sepse jo vetëm që forcon mundësinë e monitorimit të sistemit, por siguron edhe një bazë shumë të mirë të dhënash për analiza të mëtejshme. Ato duhet të shërbejnë për të nxitur proceset e inspektimeve njohëse tematike dhe territoriale në gjykata. Deri më sot, Inspektorati nuk ka traditën e programimit paraprak të inspektimeve dhe as traditën e raportimit periodik të Kryeinspektores përpara KLD-së mbi veprimtarinë e zhvilluar nga Inspektorati. Këto instrumenta duhet të aktivizohen sepse i japin jetë edhe përpunimit të rekomandimeve të përshtatshme për të ardhmen.

Sipas nenit 25 pika 4 të Rregullores së IKLD-së, ankesat e depozituara, si dhe ato të bëra publike nëpërmjet mediave, regjistrohen në Regjistrin e Ankesave. Për çdo ankesë, Regjistri tregon këto të dhëna identiteti i ankuesit, gjyqtari dhe gjykata ndaj të cilit adresohet ankesa, lënda e ankesës dhe shkelja e pretenduar, data e urdhrit të verifikimit, inspektori i ngarkuar për verifikim, datat e veprimeve të inspektorit dhe mënyra e përfundimit të verifikimit të ankesës. Në shtesë të këtyre elementëve të domosdoshëm të kërkuara nga Rregullorja, në vitin 2013 është shtuar edhe një rubrikë tjetër, për të identifikuar veçmas ankesat për etikë dhe korrupsion. Ky Regjistër mbahet në mënyrë manuale dhe krijon vështirësi për administrimin e të dhënave, si dhe për përpunimin analitik të të stastikave.

Përgjatë periudhës 01.01.2013 - 31.12.2013 numri i ankesave të paraqitura është 883, nga të cilat 838 ankesa janë paraqitur nëpërmjet shërbimit postar apo fizikisht nga ankuesit, ndërsa 45 ankesa janë paraqitur nëpërmjet postës elektronike. Pas shqyrtimit paraprak të 838 ankesave të paraqitura, **246 prej tyre janë verifikuar, ndërsa 637 ankesa janë arkivuar**. Duhet evidentuar se në çdo rast, për çdo vendim të ndërmjetëm apo përfundimtar të IKLD-së mbi ankesat (arkivimin e ankesës, fillimin e verifikimit, verifikimin në vijim apo rezultatet përfundimtare të verifikimit), ankuesi njoftohet me shkrim. Aktet e njoftimit janë përpiluar nga administrata e KLD-së (Saktori Juridik dhe i Dokumentacionit të Drejtorisë Juridike), të cilët kanë mbështetur vijimësisht IKLD-në në kryerjen e funksioneve.

Ankesat e paraqitura



- Ankesa të verifikuara

Nga verifikimi i 246 ankesave të paraqitura ka rezultuar se në 177 prej tyre janë konstatuar shkelje në veprimtarinë gjyqësore të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit. Në raport me shkeljen e identifikuar është vepruar si më poshtë:

- Në mbështetje të materialeve të verifikimit të 18 ankesave, materialet i janë përcjellë Ministrisë së Drejtësisë për të vlerësuar mundësinë e fillimit të procedimit disiplinor, si i vetmi organ i cili mund të iniciojë procedimin disiplinor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në 14 prej këtyre rasteve, është konkluduar se ka patur zvarritje të veprimeve procedurale me pasojë cenimin e të drejtave kushtetuese të palëve apo të imazhit të drejtësisë; në 3 raste është konkluduar se gjyqtari ka shkelur dispozitat procedurale urdhëruese në mënyrë të përsëritur; ndërsa në 1 rast është konkluduar se gjyqtari ka


shkelur rregullat e etikës. Në përgatitjen e këtyre materialeve duhet evidentuar se IKLD ka përmirësuar tekstin analitik të materialeve, duke shtuar në to referencat në Kodin e Etikës së Gjyqtarëve me qëllim adresimin e një prej çështjeve të ngritura në Raportin e Progresit të vitit 2013, sipas të cilit duhen më shumë përpjekje për të garantuar zbatimin e plotë të Kodit Etik.

- ii. Në mbështetje të materialeve të verifikimit të 71 ankesave, është proceduar me tërheqje vëmendje për gjyqtarin/gjyqtarët e kontrolluar bazuar në nenin 34 pika 2 të Rregullores. Shkelja dominante e konstatuar në këto raste ka qenë organizimi i dobët i punës me pasojë zvarritjen e gjykimit, shkelja e afateve procedurale të caktuara nga ligji apo shkelja e dispozitave të tjera urdhëruese për herë të parë nga gjyqtari. Në 2 prej këtyre rasteve, 2 gjyqtarëve i është tërhequr vëmendja me shkrim për shkelje të etikës së gjyqtarit;
- iii. Në mbështetje të materialeve të verifikimit të 88 ankesave, janë evidentuar shkelje shumë të lehta, të cilat janë regjistruar për efekte të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarit të kontrolluar. Natyra e këtyre shkeljeve lidhet me tejkalimin e afateve standard të gjykimit të caktuara nga KLD për efekte të vlerësimit profesional apo me cenimin e vendimeve nga gjykatat më të larta.

Në 30 raste ankesash, nga verifikimi është konstatuar se gjyqtarët e kontrolluar nuk kanë patur shkelje, ndërsa 39 ankesa janë në proces verifikimi në vijim deri në përfundim të procesit gjyqësor me një vendim përfundimtar nga shkallët më të larta.

Në ankesat e verifikuara, 63 prej tyre kanë patur për objekt shkeljen e rregullave të etikës nga gjyqtarët. Në 2 raste, ankesat e verifikuara lidheshin me çështje të deklarimit të pasurive të gjyqtarëve, por në të 2 rastet u konstatua se ankesa ishte e pabazuar. Inspektimi i këtyre rasteve paraqet vështirësi maksimale për shkak të nivelit të ulët bashkëpunues të individëve të pranishëm kur ka ndodhur shkelja dhe nevojiten teknika dhe aftësi të specializuara të inspektorëve në këtë drejtim. Për këtë qëllim ka filluar një proces bashkëpunimi me OPDAT Tiranë për të siguruar trajnimin e inspektorëve mbi këto çështje.

Ankesat e verifikuara



Nga analiza e të dhënave konstatohet se shkelja dominante e konstatuar nga procesi i verifikimit të ankesave të qytetarëve është zvarritja e gjykimeve dhe për këtë shkak IKLD ka vepruar me gjurmimin e këtyre rasteve, duke përdorur të gjitha instrumentet e njohura nga ligji. Në këtë

kontekst është menduar se kjo qasje i shërben adresimit të një prej çështjeve të ngritura nga Komisioni Europian në Raportin e Progresit të vitit 2013 lidhur me efikasitetin e sistemit gjyqësor “procedurat gjyqësore të gjata dhe joefektive dhe çështjet e prapambetura (27 623 dhe 24 415 çështje në pritje të gjykimit pranë gjykatave të rretheve dhe të apeleve në Janar 2012 dhe Janar 2011) mbetet një çështje shqetësuese”.

- Ankesa të arkivuara

Sipas nenit 27 të Rregullores së IKLD-së, një ankesë e paraqitur vlerësohet paraprakisht për elementët formalë dhe në përfundim të kësaj faze të shqyrtimit paraprak, nëse ankesa vlerësohet e papërshtatshme në formë apo në përmbajtje, atëherë procedohet me arkivimin e saj, duke njoftuar edhe ankuesin. Gjatë vitit 2013, IKLD ka proceduar me arkivimin e 637 ankesave të paraqitura, për shkaqet e listuara më poshtë:

- i. Ankesa është paraqitur tej afateve ligjore në 10 raste;
- ii. Pretendimet e ngritura në ankesë zgjidhen nëpërmjet apelimit gjyqësor në 545 raste;
- iii. Ankesa është e përsëritur dhe është trajtuar administrativisht më parë nga IKLD në 61 raste;
- iv. Ankesa lidhet me subjekte të tjera, të ndryshme nga gjyqtarët (noterë, përmbartues, avokatë, prokurorë, drejtues të organeve të pushtetit vendor etj) në 21 raste. Në 7 prej këtyre rasteve, ankesa i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë së Përgjithshme, nga të cilat në 3 raste, ankuesit ngrinin pretendime për fakte korruptive të kryera nga gjyqtarët.

Nga analiza e këtyre të dhënave konstatohet se mbetet shqetësues numri i ankesave të cilat arkivohen. Ky numër i lartë, që zë 76 % të volumit të ankesave të paraqitura, është tregues i informimit të ulët ligjor të qytetarëve mbi sistemin ligjor, të drejtat e tyre dhe mbi kompetencat e IKLD-së. Për këtë qëllim mbetet e nevojshme të përcaktohet një formë standard për ankesat, si dhe vënia në dispozicion të qytetarëve e formave standard për t'i përdorur në paraqitjen e ankesave. Gjithashtu, është e nevojshme rritja e informimit të qytetarëve (me broshura), duke siguruar që informacioni dhe formularët e ankesave të publikohen dhe aksesohen lehtësisht në faqen zyrtare të KLD-së. Në funksion të këtij qëllimi ka filluar një proces bashkëpunimi me OSBE Tiranë.

- Të dhëna të tjera

Duhet evidentuar se gjatë vitit 2013, IKLD ka finalizuar edhe një ngarkesë pune të prapambetur nga viti 2010. Duke i përmbledhur edhe rezultatet e verifikimeve të ankesave të paraqitura nga viti 2010 deri në vitin 2013, të cilat janë finalizuar në vitin 2013, të dhënat janë si më poshtë:

- i. Gjithsej për vitin 2013 janë lëshuar 105 tërheqje vëmendje, nga të cilat 19 bazuar në ankesat e vitit 2011, 15 bazuar në ankesat e vitit 2012 dhe 71 bazuar në ankesat e vitit 2013. Numri i gjyqtarëve që u është tërhequr vëmendja gjithsej është 76. Shkaqet e këtyre akteve janë shkelje etike (2 raste), mosrespektim formal i ligjit (10 raste), arsyetim i vonuar i vendimeve gjyqësore (21 raste) dhe organizim i dobët i punës me pasojë zvarritjen e gjykimit (72 raste). Duhet evidentuar se në 1 rast, gjyqtari të cilit i është

tërhequr vëmendja me shkrim për zvarritje gjykimi, paraqiti padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me vendimin e datës 7.3.2014 vendosi rrezimin e padisë me arsyetimin se akti administrativ i tërheqjes së vëmendjes ishte i bazuar në ligj dhe në aktet e grumbulluara nga Inspektorati.

- ii. I janë përcjellë Ministrit të Drejtësisë për të vlerësuar procedimin disiplinor të gjyqtarëve, materialet e 35 ankesave, nga të cilat 2 ankesa i përkasin vitit 2010, 5 ankesa vitit 2011, 7 ankesa dhe 3 informacione kryetarësh i përkasin vitin 2012, ndërsa 18 ankesa dhe 4 informacione kryetarësh i përkasin vitit 2013. 35 rastet e referuara tek Ministri i Drejtësisë i përkasin 16 gjyqtarëve të shkallës së parë¹. Shkeljet e konstatuara në verifikimet e këtyre rasteve janë zvarritja e gjykimit (24 raste), shkelje të përsëritur të dispozitave urdhëruese procedurale (10 raste) dhe shkelje etike (1 rast). Ministri i Drejtësisë ka depozituar në KLD gjatë vitit 2013, 8 kërkesa për procedim disiplinor, nga të cilat 5 kërkesa bazohen në materialet e referuara nga IKLD.
- iii. Është lëshuar 1 rekomandim drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë bazuar në nenin 34 pika 1 shkronja a) të Rregullores së IKLD-së, për përmirësimin e problematikës së konstatuar nga verifikimi i një ankese lidhur me mosmarrëveshjen për kompetencë midis gjyqtarëve të asaj gjykate, me pasojë zvarritjen e gjykimit.

Në faqen zyrtare të internetit të KLD-së, për të rritur aksesin e qytetarëve është instaluar portali i ankesave *online* <http://kld.al/ankesa-online>. Megjithatë, siç evidentohet në Raportin e Progresit të vitit 2013 “impakti i procedurës online të ankesave të qytetarëve kundër gjyqtarëve dhe procedurave gjyqësore mbetet ende për t’u vlerësuar”. Për adresimin e kësaj çështjeje është i nevojshëm një vlerësim teknik i këtij sistemi, përmirësimi i tij me modulet e nevojshme dhe shndërrimin e tij në një mjet efektiv për gjenerimin e statistikave.

¹ IKLD ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë materialet për gjithsej 17 gjyqtarë, por 1 rast i përket inspektimit tematik të Gjykatës Pukë dhe nuk është përshkruar tek verifikimi i ankesave

III.INSPEKTIMET TEMATIKE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, bazuar në nenet 143 dhe 147 të Kushtetutës, si dhe të neneve 1 dhe 16 të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001“Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar kontrollon ligjshmërinë e veprimtarisë së gjykatave dhe inspekon gjyqtarët, me qëllim respektimin e Kushtetutës, ligjeve, realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe kujdeset që kjo veprimtari të kryhet në pajtim me detyrën e gjyqtarit. Një prej mjeteve të përdorura për këtë qëllim janë edhe inspektimet tematike të Inspektoratit të KLD-së.

Në zbatim të nenit 16 pika 3 të ligjit nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i ndryshuar dhe të neneve 21 pika 10 dhe 46 të Rregullores së IKLD-së, bazuar në vendimet e KLD-së, gjatë vitit kalendarik 2013 **janë zhvilluar 4 inspektime tematike**, nga të cilat 3 janë përfunduar tërësisht, ndërsa inspektimi i katërt është në procesin e hartimit të raportit përfundimtar.

1. Inspektimi “Mbi dhunën në familje dhe masat e sigurimit për mbajtjen pa leje të armëve luftarake për periudhën 01.01.2011 – 30.06.2012”

Ky inspektim tematik u zhvillua bazuar në vendimin nr. 297/9, datë 15.11.2012 të KLD-së dhe në urdhrin nr.102, datë 14.01.2013 të Zëvendëskryetarit të KLD-së. Inspektimi pati në objektin e tij kontrollin e dy temave:

- i. Roli i Gjykatave në luftën kundër dhunës në familje nëpërmjet kontrollit të çështjeve me objekt “Lëshimin e urdhrin të menjëhershëm të mbrojtjes” dhe “Lëshimin e urdhrin të mbrojtjes”;
- ii. Roli i Gjykatave forcimin e sigurisë publike nëpërmjet kontrollit të çështjeve për caktimin e masave të sigurimit personal për të dyshuarit për kryerjen e veprave penale të prodhimit e mbajtjes pa leje të armëve luftarake.

Kontrollit iu nënshtruan 28 gjykata të vendit, nga të cilat 6 gjykata të apeleve dhe 22 gjykata të shkallës së parë. Këto gjykata janë Gjykatat e Apeleve Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastër, si dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër, Krujë, Kurbin, Mat, Tiranë, Elbasan, Durrës, Kavajë, Lezhë, Kukës, Pukë, Shkodër, Tropojë, Berat, Fier, Lushnjë, Vlorë, Korçë, Pogradec, Gjirokastër, Sarandë dhe Përmet.

Inspektimi u zhvillua bazuar në tre faza duke respektuar procedurën e përcaktuar në ligj dhe në Rregulloren e Inspektoratit, si dhe standardet e metodologjinë e Manualit të Inspektimeve. Në fazën e parë të veprimtarisë paraprake u përcaktua kalendari i punës dhe u grumbullua materiali dokumentar nga gjykatat, ndërsa në fazën e dytë u realizua inspektimi në gjykata ku u verifikuan rezultatet e fazës paraprake. Në fazën e tretë dhe të fundit, u procedua me përpunimin e materialit të grumbulluar dhe me hartimin e këtij Raporti. Inspektimi u realizua nga një grup kontrolli i përbërë prej 6 inspektorëve Arjan Qafa, Dashuri Gjunksi, Fatbardh Çoniku, Izet Salaj, Piro Samara dhe Qemal Zaimi. Procesi i analizës dhe i përpilimit të raportit i është nënshtruar përputhshmërisë me legjislacionin dhe standardizimit të të dhënave e analizës në rrugë hierarkike prej Kryeinspektores Marsida Xhaferllari.

Periudha e zgjedhur për inspektim ishte një vit e gjysmë 01.01.2011 - 30.06.2012, e cila dha mundësinë për njohjen e situatës së veprimtarisë gjyqësore në një volum relativisht të lartë, si dhe për njohjen e ecurisë së vendimeve të dhëna gjër në Gjykatën e Lartë. Në përfundim të këtij inspektimi u konkludua se ka vend për përmirësim në procedurat për shqyrtimin e kërkesave për mbrojtjen nga dhuna në familje. Përmirësimi i situatës kërkon ndërhyrje ligjore dhe administrative. Po ashtu, u konkludua se duhet të standardizohet praktika gjyqësore për masat e sigurimit ndaj të dyshuarve të veprës penale të mbajtjes pa leje të armëve luftarake. Nga analiza e këtyre gjetjeve, u dhanë 8 rekomandime, një pjesë e të cilave lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë e KLD-së, ndërsa një pjesë me institucionet e treta. Në formulimin e rekomandimeve u mbajt në konsideratë fakti se fenomeni i dhunës në familje kërkon një reagim të bashkërenduar të institucioneve shtetërore.

2. Inspektimi i mësimdhënies

Inspektimi tematik u zhvillua bazuar në vendimin 364, datë 18.09.2013 të KLD-së dhe në urdhrin nr. 67, datë 03.10.2013 të Zëvendëskryetarit të KLD-së. Inspektimi pati në objektin e tij kontrollin e dy temave:

- i. Ushtrimi i veprimtarisë së mësimdhënies nga gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë dhe të apelit për vitin akademik 2012-2013 në këndvështrim të respektimit të rregullave të përcaktuara në Vendimin e KLD-së nr. 278/2 datë 19.07.2011 “Për veprimtarinë akademike të gjyqtarëve”.
- ii. Evidentimi i pasojave që ushtrimi i veprimtarisë së mësimdhënies mund të ketë sjellë në ushtrimin e funksionit të gjyqtarit, si dhe shpërblimi i marrë në raport me pagën e gjyqtarit.

Kontrollit iu nënshtruan 30 gjykata gjithsej (22 gjykata të rretheve gjyqësore, gjykata e shkallës së parë për krime të rënda, 6 gjykata të apelit civil dhe gjykata e apelit për krime të rënda). Periudha e zgjedhur për inspektim ishte viti akademik 01 Tetor 2012- 31 Shtator 2013.

Inspektimi u zhvillua bazuar në tre faza duke respektuar procedurën e përcaktuar në ligj, në Rregulloren e Inspektoratit dhe standardet e metodologjinë e Manualit të Inspektimeve. Në fazën e parë të veprimtarisë paraprahe u përcaktua kalendari i punës dhe u grumbullua materiali dokumentar nga gjykatat, Ministria e Arsimit dhe e Sportit dhe institucionet e arsimit të lartë, ndërsa në fazën e dytë u realizua inspektimi në gjykata ku u verifikuan rezultatet e fazës paraprahe. Në fazën e tretë dhe të fundit, u procedua me përpunimin e materialit të grumbulluar dhe me hartimin e këtij Raporti. Inspektimi u realizua nga një grup kontrolli i përbërë prej 4 inspektorëve Izet Salaj, Zhaneta Pira, Marsela Pepi dhe Qemal Zaimi, nën drejtimin e kryeinspektores Marsida Xhaferllari.

Në përfundim të këtij inspektimi u konkludua se ka vend për përmirësim në procedurat për autorizimin e veprimtarisë akademike të gjyqtarëve për t'i dhënë epërsinë e duhur funksionit të gjyqtarit dhe pacenueshmërisë së këtij funksioni. Përmirësimi i situatës kërkon ndërhyrje ligjore dhe administrative. Nga analiza e gjetjeve të inspektimit, u dhanë 6 rekomandime, një pjesë e të cilave lidhen drejtpërdrejt me veprimtarinë e KLD-së, ndërsa një pjesë me institucionet e treta.

3. Inspektimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 404, datë 3.12.2013 vendosi inspektimin e veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, Shtjefën Lleshi dhe të administratës gjyqësore të asaj gjykate, lidhur me ankesën e bërë publike nga televizioni “Top Channel”, për shkelje të etikës dhe mosrespektim formal të ligjit, në shqyrtimin e çështjeve të përmendura në këtë televizion. Për kryerjen e këtij inspektimi u ngarkua Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe ai i Ministrisë së Drejtësisë.

Inspektimi u realizua nga një grup inspektimi i përbërë prej inspektorëve Izet Salaj e Qemal Zaimi të IKLD-së, si dhe inspektorëve Petrit Kaja e Entela Dobi të Inspektimit Gjyqësor në Ministrinë e Drejtësisë.

Inspektimi u zhvillua bazuar në tre faza në përputhje me programin paraprak të tij, të miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 366 prot, datë 13.12.2013 të Zëvendëskryetarit të KLD-së dhe të Ministrisë së Drejtësisë. Në fazën e parë të veprimtarisë paraprake u përcaktua kalendari i punës; në fazën e dytë u realizua inspektimi në gjykatë në datat 18-19 dhjetor 2013 dhe grumbullimi i materialit të nevojshëm, ku u përfshinë edhe rezultatet paraprake të përgatitura nga Inspektorati i KLD-së, në verifikimin e datës 02.12.2013. Në fazën e tretë dhe të fundit, u procedua me përpunimin e materialit të grumbulluar dhe me hartimin e këtij Raporti. Procesi i analizës dhe i përpilimit të raportit i është nënshtruar përputhshmërisë me legjislacionin në rrugë hierarkike brenda dy inspektorateve, përkatësisht prej Kryeinspektore Marsida Xhaferllari dhe prej Drejtorit të Përgjithshëm Sokol Pasho. Në zhvillimin e këtij inspektimi u ndoq procedura e përcaktuar në ligj dhe në Rregulloren e Inspektoratit, si dhe standardet e metodologjia e përcaktuar në Manualin e Inspektimeve.

Në përfundim të këtij inspektimi u konkludua se gjyqtari Shtjefën Lleshi ka shkelur dispozitat urdhëruese procedurale penale në procedurën e shqyrtimit të zëvendësimit të masave të sigurimit dhe mbi detyrimin për arsyetimin e vendimit gjyqësor, të cilat dëmtojnë dhënien e drejtësisë dhe kompromentojnë drejtësinë e dhënies së vendimeve. Nga analiza e këtyre shkeljeve janë dhënë 5 rekomandime, ku rekomandimi kryesor lidhet me procedimin disiplinor të gjyqtarit Shtjefën Lleshi.

4. Inspektimi i Procedurave të Shortit

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 307, datë 08.03.2012, ka vendosur inspektimin e veprimtarisë së kryetarëve të gjykatave në hedhjen e shortit të çështjeve dhe ndarjen në dhoma të gjyqtarëve. Këtij inspektimi i janë nënshtruar të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit – 30 gjithsej (22 gjykata të rretheve gjyqësore, gjykata e shkallës së parë për krime të rënda, 6 gjykata të apelit civil dhe 1 gjykatë apeli për krimet e rënda). Periudha e zgjedhur për kontroll është 6 mujore (nëntor 2012 - prill 2013) dhe muaji korrik i vitit 2013, në të cilin u kontrollua zhvillimi teknik i shortit nëpërmjet pjesëmarrjes direkte të inspektorëve në procedurat e shortit. Po ashtu, inspektorët kanë verifikuar në këtë inspektim edhe të gjitha ankesat e qytetarëve që lidhen me shortin, të paraqitura nga data 01.01.2012 deri në korrik 2013. Aktualisht, ky inspektim është në fazën e hartimit të raportit përfundimtar dhe vonesa lidhet me përcaktimin e prioritetëve të tjera për inspektorët bazuar në udhëzimet e KLD-së në mbledhje plenare (dy inspektimet e mësimdhënies dhe të Gjykatës Pukë).

IV. VLERËSIMI PROFESIONAL TË GJYQTARËVE

Një përgjegjësi tjetër shumë e rëndësishme e Inspektoratit është grumbullimi i të dhënave dhe hartimi i projektakteve të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve (nenet 16 pika 1 shkronja 'dh' të ligjit nr. 8811/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së", i ndryshuar dhe neni 13 i ligjit nr. 9877/2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh", i ndryshuar). Inspektorati ka filluar veprimtarinë për zbatimin e Sistemit të Vlerësimit në vitin 2007 me gjyqtarët e gjykatës së rrethit gjyqësor Elbasan, por data e saktë nuk është dokumentuar. Deri në datën 01.01.2013, IKLD kishte paraqitur për shqyrtim dhe miratim në KLD vetëm 31 akte vlerësimi. Deri në këtë datë nuk kishte asnjë gjykatë nga 30 gjithsej, për të cilën të kishte përfunduar sistemi i vlerësimit për të gjithë gjyqtarët që ushtrojnë veprimtarinë në të. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan kishte ende 5 gjyqtarë të pavlerësuar përfundimisht.

Procesi kishte mbetur në fazën e dytë, konkretisht në fazën e përpunimit të informacionit nga inspektorët dhe në përgatitjen e projektaktit përfundimtar të vlerësimit nga Kryeinspektori. Nga një përlllogaritje e thjeshtë rezultonte se ishin rreth 100 gjyqtarë, që kërkonin promovim, për të cilët nuk kishte përfunduar vlerësimi përfundimtar.

Në Raportin Analitik të Komisionit Europian për Shqipërinë 2010 është evidentuar si problematikë kryesore mungesa e një sistemi vlerësimi për gjyqtarët, që shkakton uljen e nivelit të cilësisë dhe dobësimin e pavarësisë së sistemit gjyqësor në Shqipëri. Kjo shoqërohet edhe me mungesën e një sistemi transferimesh dhe promovimesh bazuar në meritat profesionale. Në Raportin e Progresit të vitit 2011 për Shqipërinë evidentohet se ka patur progres të kufizuar lidhur me eficientësinë e sistemit gjyqësor. Është përmirësuar sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve, si dhe çështja e arsytimit të vendimeve të KLD-së mbi promovimin e gjyqtarëve. Megjithatë, efektiviteti i sistemit të ri të vlerësimit duhet verifikuar në praktikë. Edhe Raporti i Progresit i vitit 2012 sërish vë theksin tek zbatimi i vlerësimit profesional të gjyqtarëve, duke evidentuar se sistemi i vlerësimit ende nuk është zbatuar plotësisht. Sipas Komisionit Europian, ky fakt ka ndikim në veprimtarinë e transferimeve, promovimeve dhe emërimeve të gjyqtarëve. Ndërsa në Raportin e Progresit të vitit 2013 shënohet "vlerësimi i gjyqtarëve – i cili ende nuk ka përfunduar – është një kërkesë thelbësore për një proces transparent dhe të bazuar në merita për emërimin, transferimin dhe promovimin e tyre". Mbi këtë bazë, prioriteti kryesor i IKLD, i përcaktuar nga KLD ishte finalizimi i shpejtë dhe efektiv i raundit të parë të vlerësimeve 2005-2006.

Përgjatë vitit kalendarik 2013, IKLD ka hartuar dhe paraqitur për shqyrtim, në mbledhje plenare të KLD-së, gjithsej 250 akte të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit. 248 prej këtyre akteve i përkasin vlerësimit të periudhës kohore 2005-2006. Ndërsa 2 prej akteve i përkasin periudhës 2007-2009 për shkak të vlerësimit të 2 gjyqtarëve "Pranueshëm" për periudhën kohore 2005-2006. Në raundin e dytë të vlerësimit, këta 2 gjyqtarë u vlerësuan "Mirë". Shqyrtimi dhe miratimi i 250 akteve të vlerësimit të përgatitura nga IKLD është përfunduar nga KLD më 17.01.2014.

Në këtë mënyrë u realizua për herë të parë në Republikën e Shqipërisë raundi i parë i vlerësimit profesional të gjyqtarëve për vitet 2005-2006, të cilit iu nënshtruan 279 gjyqtarë. Përfundimi i këtij procesi u realizua në sajë të punës voluminoze të stafit të përfshirë në këtë

proces. Rezultatet e këtij procesi lehtësuan edhe në hartimin e listës përfundimtare të renditjes së gjyqtarëve, si dhe ndikuan në procesin e promovimeve dhe të transferimeve të gjyqtarëve.

41 prej gjyqtarëve të vlerësuar ushtronin detyrën në Gjykatat e Apelit, nga të cilët 8 në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, 3 në Gjykatën e Apelit Ushtarak dhe 30 gjyqtarë në Gjykatat e Apelit Civil. 238 gjyqtarë ushtronin detyrën në shkallë të parë, nga të cilët 13 në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe 225 gjyqtarë në 28 gjykata të rretheve gjyqësore. Nga 279 gjyqtarë të vlerësuar, 114 prej tyre ishin femra, ndërsa 165 meshkuj.

Mbledhja fillestare e dokumentacionit që në vitin 2007 është kryer prej inspektorëve Mine Progonati, Hysen Saliko, Lazer Sallaku, Alma Brati, Elda Vrioni, Flutura Hoxha, Selim Kryeziu, Arjan Balliu, Izet Salaj, Qemal Zaimi, Fatbardh Çoniku, Arjan Qafa, Piro Samara, Dashuri Gjunksi, Zhaneta Pira, Hajrie Muçmata e Vojsava Osmanaj. Duhet evidentuar se në vitin kalendarik 2013, për shkak të impulsit të ri të punës në IKLD për t’iu përgjigjur prioriteve të caktuara nga KLD, dokumentacioni i grumbulluar u rishikua tërësisht nga inspektorët Hajrie Muçmata, Vojsava Osmanaj, Fatbardh Çoniku, Selim Kryeziu dhe Arjan Balliu. Gjithashtu, gjatë vitit 2013 është grumbulluar dhe përpunuar dokumentacioni fillestar deri në përfundimin e aktit të vlerësimit për 10 gjyqtarë (6 në gjykatat e apelit dhe 4 në shkallën e parë).

Të dhënat e vlerësimit të 279 gjyqtarëve nga IKLD janë si më poshtë:

Nr	Vlerësimi	Apel	Shkalla I	Gjithsej
1	Shumë Mirë (4)	21	52	73
2	Shumë Mirë (3)	16	88	104
3	Shumë Mirë (2)	1	0	1
4	Mirë	7	89	96
5	Pranueshëm	0	5	5

Të dhënat e vlerësimit të 279 gjyqtarëve nga KLD janë si më poshtë:

Nr	Vlerësimi	Apel	Shkalla I	Gjithsej
1	Shumë Mirë (4)	23	85	108
2	Shumë Mirë (3)	17	80	97
3	Shumë Mirë (2)	3	17	20
4	Mirë	3	48	51
5	Pranueshëm	0	3	3

Shkaqet kryesore të cenimit të akteve të Inspektoratit janë si më poshtë:

- Analiza e vendimeve të cenuara, me tendencën e përmirësimit të cilësisë së gjyqtarit. Kjo e dhënë jepte impakt në dy grupkriteret II “Aftësitë profesionale juridike dhe teknike” dhe IV “Aftësitë e angazhimit profesional”;
- Informacioni i pasaktë i Shkollës së Magjistraturës dhe angazhimi i gjyqtarit në procese të tjera akademike. Në disa raste, gjyqtarët paraqisnin së bashku me ankimin, vërtetime të reja nga Shkolla e Magjistraturës apo kopje të çertifikatave të marra prej saj. Gjithashtu, gjyqtarët paraqitnin edhe vërtetime për përfshirjen e tyre në programe të studimeve pasuniversitare, madje edhe pas periudhës së vlerësimit. Këto të dhëna jepnin impakt në

dy grupkriteret II “Aftësitë profesionale juridike dhe teknike” dhe IV “Aftësitë e angazhimit profesional” ;

- Shkaqet justifikuese të paraqitura nga gjyqtarët për zvarritjen e gjykimeve dhe tejkalimin e afateve në arsyetimin e vendimeve gjyqësore. Në disa raste, gjyqtarët paraqitnin të dhëna individuale mbi vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore apo të gjykimeve, duke ia atribuar vonesat stafit administrativ në gjykata. Në disa raste të tjera, gjyqtarët paraqitnin të dhëna mbi kushtet e veçanta familjare dhe shëndetësore të tyre. Këto të dhëna jepnin impakt në dy grupkriteret I “Aftësitë profesionale të përgjithshme” dhe III “Aftësitë organizuese dhe zbatuese”.

Përgjithësisht, ndryshimi i akteve të IKLD-së është bërë bazuar në ankimin e gjyqtarit, megjithatë në 2 raste, akti është ndryshuar kryesisht nga KLD, pa ankim të gjyqtarit.

Vetëm 3 gjyqtarë janë ankuar në gjykatë për rezultatin e vlerësimit të miratuar nga KLD-ja. Në 1 rast, gjykimi është pushuar për shkak të tërheqjes së padisë nga vetë gjyqtari. Në dy rastet e tjera, gjykimi ka përfunduar në shkallë të parë me rrëzimin e padisë së gjyqtarëve për ndryshimin e vlerësimit. Në të dyja këto raste, gjyqtarët kanë paraqitur apel dhe çështjet janë për shqyrtim pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Sistemi i Vlerësimit 2005-2006 bazohet në disa të dhëna objektive, të cilat janë përcaktuar si standarde matëse nga KLD në drejtim të aspektit sasior, aspektit cilësor dhe aspektit kohor. Nga analiza e të dhënave të grumbulluara janë konstatuar të dhënat e mëposhtme:

(i) Aspekti sasior

Në raport me standardet e caktuara nga KLD, përgjithësisht gjykatat e shkallës së parë janë nën standardet sasiorë të caktuara – 200 çështje penale (krime dhe kundravajtje) dhe civile me palë kundërshtare për gjyqtar për gjykatat e organizuara në seksione, si dhe 100, 120 apo 150 çështje penale, civile të përgjithshme dhe administrative. Këtu bëjnë përjashtim gjykatat me ngarkesë të lartë pune, siç është rasti i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. I njëjti konkluzion qëndron edhe për gjykatat e apelit, si dhe për gjykatat për krime të rënda.

Nga ana tjetër, duhet evidentuar se Sistemi i Vlerësimit anashkalon ngarkesën e gjyqtarit në tre drejtime. Së pari, ai anashkalon çështjet pa palë kundërshtare apo çështjet me palë kundërshtare, por jashtë lëndës së seksionit ku bën pjesë gjyqtari. Së dyti, Sistemi i Vlerësimit anashkalon çështjet gjyqësore, në të cilat gjyqtari ka marrë pjesë si anëtar i trupit gjykues. Së treti, anashkalon çështjet, të cilat gjyqtari i gjykon për shkak delegimi nga KLD në një gjykatë tjetër, të cilat nëse vendoset se duhet të përfshihen duhet të kenë një peshë të diferencuar për shkak të vështirësisë së lëvizjes së gjyqtarit nga zyra.

(ii) Aspekti cilësor

Cilësia e vendimarrjes në gjykatat e shkallës së parë është klasifikuar në nivelin **Mirë**, megjithatë lidhur me këtë tregues është konstatuar se një numër i ulët gjyqtarësh, statistikisht kanë patur cilësi vendimmarrje në nivelin Shumë Mirë. Po ashtu, është konstatuar edhe një numër

gjyqtarësh, të cilët kanë qenë në nivelin I Paaftë për shkak të të dhënave të cilësisë nën standardin minimal 30 %.

Ndërsa cilësia e vendimarrjes në gjykatat e apelit përgjithësisht është klasifikuar në nivelin **Shumë Mirë**. Ky vlerësim është rezultat i faktit se numri i vendimeve të rekursuara është relativisht i ulët dhe në shumicën e rasteve, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e ankimit.

Lidhur me këtë tregues, ka patur një numër ankimesh nga gjyqtarët, të cilët kanë ngritur pretendimin se statistika strikte nuk tregon cilësinë e tyre të vendimarrjes, pasi shkaqet e cenimit në shkallët më të larta në shumë raste janë abuzive. Ky pretendim nuk duhet të përkrahet për 3 arsye: (i) së pari, kjo e dhënë është e natyrës objektive dhe i jep paanësi sistemit të vlerësimit; (ii) sistemi gjyqësor në Shqipëri është i organizuar në mënyrë hierarkike, duke i besuar kontrollit të brendshëm dhe për pasojë, vendimet e gjykatave më të larta nuk duhen vënë në diskutim; (iii) së treti, e dhëna mbi cilësinë e vendimarrjes merret në analizë nga Sistemi i Vlerësimit me metodologji të kombinuar me të dhënat e tjera të gjyqtarit, që nënkupton se kjo e dhënë nuk gjeneron automatikisht rezultatin përfundimtar.

(iii) Aspekti kohor

Në raport me standardet e përcaktuara në vendimin nr. 199, datë 15.09.2006 të KLD-së, i cili jep standardet minimale kohore, gjykatat e shkallës së parë janë vlerësuar **Shumë Mirë** për aspektin kohor, me përjashtim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për shkak të volumit të lartë sasior që ka patur kjo gjykatë. Gjithashtu, ka patur edhe raste individuale gjyqtarësh me të dhëna më të dobëta në këtë aspekt. Shkaqet e zvarritjes janë evidentuar: (i) thirrja dhe njoftimi i palëve; (ii) marrja e provave; (iii) mungesa të gjyqtarit apo anëtarit të trupit gjykues; (iv) njoftimi me shpallje publike; (v) plotësimi i të metave të padisë.

Edhe gjykatat e apelit për aspektin kohor janë vlerësuar **Shumë Mirë**. Në këto gjykata është konstatuar si problematikë mbajtja e çështjes gjyqësore në pritje për gjykim dhe kompetenca e kryetarit të Gjykatës për caktimin e seancës së parë gjyqësore, ndonëse shorti organizohej rregullisht.

Lidhur me këtë tregues, konstatohet se ka vend për përmirësimin e standardeve matëse me qëllim diferencimin e gjyqtarit nga gjyqtari.

- Trajnimi i gjyqtarëve

Sipas nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve. Në raport me detyrimin ligjor, në përgjithësi gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit janë vlerësuar **Pranueshëm** për aspektin e aktivizimit në trajnimet profesionale. Ky fakt i atribuohet mënyrës së organizimit të thirrjes dhe pjesëmarrjes së gjyqtarëve në këto aktivitete në vitet 2005-2006 dhe mungesës së interesit të gjyqtarëve për këto aktivitete. Nga analiza e të dhënave konstatohet se mbetet çështje

shqetësuese përshtatja e specializimit të gjyqtarit me aktivitetet trajnuese sepse nuk kanë munguar rastet kur një gjyqtar i seksionit penal trajnohej për çështje familjare apo raste të tjera të kësaj natyre. Gjithashtu, mbetet çështje për t'u zgjidhur standardi matës i aftësisë së gjyqtarit për të marrë pjesë aktive në këto trajnime.

Së fundmi, duhet evidentuar se gjatë vitit 2013 IKLD përgatiti edhe kalendarin e gjykatave dhe gjyqtarëve që do të vlerësohen nga Inspektorati i KLD gjatë vitit 2014 për periudhën 2007 – 2009. Ky kalendar, në përputhje me nenin 2 pika 6 të vendimit nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” u paraqit për shqyrtim dhe u miratua nga KLD në mbledhjen plenare të datës 16.12.2013.

➤ **Vlerësimi i punës së kryetarëve të gjykatave**

Në bazë të nenit 9 të Vendimit nr. 227/2, datë 28.03.2008 “Për funksionin drejtues në gjykata”, Kryeinspektori i KLD-së, një herë në dy vjet ose kur kërkohet nga KLD, paraqet një raport për punën e kryer nga kryetari i gjykatës. Ky raport duhet të bazohet edhe në:

- a. Raportin e të deleguarit pjesëmarrës të KLD-së në analizat vjetore të gjykatës, e veçanërisht për punën e kryetarit;
- b. Vizitat e anëtarëve të KLD-së në gjykata gjatë mandatit të kryetarit;
- c. Materiale që vijnë nga Ministri i Drejtësisë;
- d. Materiale të tjera që rezultojnë nga verifikimet apo kontrollet gjatë periudhës që ai ka qenë në detyrën e kryetarit të gjykatës.

Gjatë vitit 2013 nuk është kërkuar nga KLD kryerja e vlerësimit të punës së kryetarëve të gjykatave. Në këto rrethana është vlerësuar se kjo detyrë të kryhet nga IKLD gjatë vitit 2014, që përkon me periudhën 2 vjeçare edhe të fillimit të detyrës nga Kryeinspektorja aktuale. Është menduar që procesi të fillojë me programin për vlerësimin e kryetarëve në detyrë, si dhe me mbledhjen e dokumentacionit të nevojshëm.

V. DELEGIMET E GJYQTARËVE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë, në zbatim të neneve 1 dhe 2 shkronja f) të ligjit r.8811 datë 17.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së", i ndryshuar dhe të nenit 21 pika 2 të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh", i ndryshuar, ka nxjerrë vendimin nr. 319, datë 03.05.2013 "Për kriteret dhe mënyrën e delegimit të gjyqtarëve për shqyrtimin e një çështjeje gjyqësore". Me anë të këtij vendimi, IKLD është ngarkuar me përpunimin e të gjitha kërkesave, duke përgatitur relacion të detajuar dhe tabelat për çdo çështje apo grup çështjesh që i përkasin të njëjtës gjykatë, me qëllim propozimin KLD-së, për gjyqtarin/gjyqtarët konkretë të gjykatës nga ku do të kryhet delegimi në zbatim të kriterëve të delegimit. Rregullat e caktuara nga KLD reflektojnë parimet themelore të administrimit të drejtësisë, si dhe garantojnë një procedurë të qartë dhe të drejtë të delegimit të gjyqtarëve për të bërë të zbatueshëm parimin e gjyqtarit natyral. Procesi i delegimit të gjyqtarëve jep impakt në efektivitetin dhe integritetin e procedurave të caktimit të gjyqtarëve në një çështje gjyqësore, si një komponent i rëndësishëm i procesit të rregullt gjyqësor të parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës, i cili përbën edhe një prej të drejtave themelore më të rëndësishme të individit të sanksionuar nga neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjatë vitit 2013 janë depozituar në Këshillin e Lartë të Drejtësisë gjithsej **496 kërkesa nga kryetarët respektivë të gjykatave për delegimin e 583 gjyqtarëve në 496 çështje**, me motivacionin se nuk kanë mundësi të shqyrtojnë një apo disa çështje brenda afateve të arsyeshme kohore. Përpunimi i kërkesave është realizuar me mbështetjen e Sektorit Juridik dhe të Dokumentacionit të Drejtorisë Juridike.

Nga Gjykatat e Apeleve janë paraqitur gjithsej 267 kërkesa (124 kërkesa për delegime për çështjet penale dhe 143 për çështjet civile), për delegimin e 473 gjyqtarëve në 267 çështje gjithsej. Nga Gjykatat e Shkallës së Parë janë paraqitur 229 kërkesa (105 kërkesa për delegime për çështjet penale dhe 124 për çështjet civile). Nga këto duhen veçuar 124 çështjet (46 çështje penale dhe 78 çështje civile) e gjykatës së rrethit gjyqësor Dibër për gjykimin e të cilave janë deleguar 4 gjyqtarët e gjykatës së rrethit gjyqësor Mat, si dhe 22 çështjet (21 çështje penale dhe 1 çështje civile) e gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës për gjykimin e të cilave janë deleguar 3 gjyqtarë. Nga 229 çështje gjithsej nga gjykatat e tjera të shkallës së parë janë paraqitur 83 kërkesa për delegimin e 103 gjyqtarëve në 83 çështje, të cilat janë 45 çështje civile dhe 38 çështje penale. Këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Gjykatat e Apelit				
Nr	Gjykata	Çështjet		Gjyqtarë
		Penale	Civile	
1	Apeli Durrës	17	3	29
2	Gjirokastrë	30	52	122
3	Korçë	19	32	100
4	Shkodër	15	7	37
5	Tiranë	0	0	0
6	Vlorë	29	49	143
7	Krimet e Rënda	14	-	42
8	Apeli Administrativ	-	0	
Gjithsej		267		473

Gjykatat e Shkallës së Parë				
Nr.	Gjykata	Çështjet		Gjyqtarë
		Penale	Civile	
1	Berat	0	0	0
2	Dibër	46	79	6
3	Durrës	22	1	4
4	Elbasan	1		3
5	Fier		1	1
6	Gjirokastrë	1	2	3
7	Kavajë	8	1	12
8	Korçë	0	0	0
9	Krujë	1	1	2
10	Kukës	1		1
11	Kurbin	6	5	17
12	Lezhë	1	1	2
13	Lushnje	1	4	5
14	Mat	1	7	10
15	Përmet	1	1	2
16	Pogradec		1	1
17	Pukë	5	1	10
18	Sarandë	4	12	17
19	Shkodër	1		1
20	Tiranë		1	1
21	Tropojë	4		5
22	Vlorë		4	4
23	Shkalla e Parë për K.Rënda	1		1
24	Administrative Gjirokastrë		1	1
25	Administrative Korçë		1	1
Gjithsej		229		110

Analiza e këtyre të dhënave tregon se procesi i delegimeve duhet të jetë në fokus monitorimi për dy arsye bazë: (i) numri i lartë i kërkesave të paraqitura shton kostot financiare të procesit gjyqësor nga njëra anë, por edhe zgjat kohën e gjykimit në dëm të palëve nga ana tjetër; (ii) të dhënat tregojnë se numri i kërkesave është më i lartë në shkallën e dytë se sa në gjykatat e shkallës së parë dhe një monitorim i kujdesshëm duhet të nxjerrë në pah eficientë e organizimit gjyqësor. Në kontekstin e monitorimit të këtij procesi, duhet evidentuar se një prej faktorëve që ndikon ndjeshëm në numrin e lartë të kërkesave për delegime është edhe numri i lartë i heqjeve dorë apo përjashtimeve të gjyqtarëve nga procese konkrete. Gjithashtu, vlerësohet se ka nevojë për një bazë elektronike të dhënash për menaxhimin transparent dhe efektiv të këtij procesi që nga momenti i paraqitjes së kërkesës në KLD gjer në organizimin e shortit të gjyqtarëve për delegim.

VI. RAPORTIMI PERIODIK I KRYETARËVE TË GJYKATAVE

Duke marrë shkas nga problematika e evidentuar nga inspektimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Elbasan mbi vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, si pasojë e të cilave u shkarkuan nga detyra dy gjyqtarë, Zëvendëskryetari i KLD-së me shkresën nr. 1464 prot., datë 25.09.2012 iu drejtua të gjithë kryetarëve të gjykatave me kërkesë për informim periodik mbi çështjet e mëposhtme:

- i. Respektimin e afatit të dorëzimit të vendimeve të arsyetuara në sekretarinë gjyqësore;
- ii. Probleme të respektimit të disiplinës në punë;
- iii. Respektimin e normave të etikës gjyqësore me palët pjesëmarrëse, me kolegët dhe titullarin e gjykatës
- iv. Zbatimin e vendimit nr. 232/8, data 07.07.2008 të KLD-së “Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit;
- v. Vonesat e seancave gjyqësore;
- vi. Çdo situatë tjetër problematike të konstatuar.

Gjatë vitit 2013, prej kryetarëve të gjykatave është paraqitur informacioni periodik i kërkuar në lidhje me problematikën e konstatuar në gjykatat respektive. Në disa muaj ku nuk është raportuar nga të gjitha gjykatat ç’ka është pasqyruar në analizën e bërë në materialin mujor të paraqitur pranë Zëvendëskryetarit të KLD-së çdo muaj. Vlerësimi i këtyre informacioneve është kryer si proces me mbështetjen e Sektorit Juridik dhe të Dokumentacionit të Drejtorisë Juridike.

Nga analiza e të dhënave të paraqitura përgjatë gjithë vitit është konstatuar se problematika kryesore e referuar lidhet me vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

Muaji	Nr. Gjyqtarëve		Nr. Gjykatave		Nr. Vendimeve	
	Apel	Shkalla 1	Apel	Shkalla 1	Apel	Shkalla 1
Janar	1	9	1	3	2	19
Shkurt	1	6	1	3	9	25
Mars	1	10	1	2	4	25
Prill	3	3	2	2	9	14
Maj	5	11	3	4	25	33
Qershor	2	14	2	5	10	30
Korrik	3	13	3	7	12	83
Shtator	2	7	1	3	2	55
Tetor	4	2	3	2	15	17
Nëntor	5	5	3	2	34	7
Dhjetor	3	2	2	2	32	4
Gjithsej²	16	44	6	10	154	312

Nga analiza e të dhënave konstatohet se tendenca për numrin e gjyqtarëve deri në muajin Korrik përgjithësisht ka qënë në rritje, duke u ulur pas këtij muaji. E njëjta gjë konstatohet edhe për tendenën e numrit të gjykatave, e cila pas muajit korrik përgjysmohet. Lidhur me numrin e vendimeve vërehet se nuk ka një tendencë të qëndrueshme. Deri në muajin Prill tendenca është

² Në nxjerrjen e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve dhe të gjykatave, është mbajtur në konsideratë, që i njëjti gjyqtar apo e njëjta gjykatë ka patur vonesa në muaj të ndryshëm

në ulje, në Maj numri dyfishohet, duke rënë në Qeshor, për të vijuar me një rritje të ndjeshme në Korrik (për shkak të lejes vjetore të gjyqtarëve), ndërsa pas Shtatorit, kjo tendencë është e qëndrueshme.

Raporti i Progresit i vitit 2013, lidhur me përgjegjshmërinë e gjyqësorit, ndër të tjera thekson “Nuk ka patur progres në përmirësimin e vendimeve gjyqësore, sidomos përsa i përket arsytimit. Për më tepër, vendimet gjyqësore përgjithësisht shpallen pa arsytim, i cili në shumicën e rasteve bëhet pas një vonese domethënëse”. Për këtë arsye, kjo çështje është mbajtur në vëmendje konstante dhe të gjitha rastet e vonuara janë verifikuar. Procesi i verifikimit është mbështetur në nenin 21 të Rregullores së IKLD-së, pika 2 e të cilit parashikon se IKLD verifikon në çdo rast shqetësimet apo informacionet e përcjellura nga kryetarët. Nga rezultatet e verifikimit në vitin 2013 janë përfutur këto rezultate:

- i. Materialet e verifikimit për 5 gjyqtarë i janë përcjellë Ministrit të Drejtësisë për procedim disiplinor me arsytimin e shkeljes së përsëritur dhe të pajustificuar të dispozitave procedurale urdhëruese me pasoja për të drejtën kushtetuese të palëve për një proces të rregullt gjyqësor dhe për dhënien e drejtësisë;
- ii. Në rastin e verifikimit të 17 gjyqtarëve të konstatuar me shkelje, i është tërhequr vëmendja me shkrim bazuar në nenin 34 pika 2 të Rregullores së IKLD-së me arsytimin se rasti i verifikuar ka qenë i pamjaftueshëm për të iniciuar përshtatshëm një procedim disiplinor. Në këto raste është konstatuar që numri i vendimeve të arsyetuara me vonesë prej tyre ka qenë i ulët dhe se vonesa e gjyqtarit ka qenë rezultat edhe i ngarkesës së tij në detyrë;
- iii. Për 12 gjyqtarë, rezultatet e verifikimit janë regjistruar për efekte të vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarit;
- iv. Në 3 raste është nxjerrë përfundimi se vonesa nuk i atribuohet veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve, por stafit administrativ të gjykatës dhe për rrjedhojë materialet i janë përcjellë Ministrit të Drejtësisë për kompetencë.
- v. Një pjesë e të dhënave të nxjerra nga raportimet e muajit nëntor dhe dhjetor janë verifikuar dhe janë në procesin e përpunimit të rezultateve të verifikimit.

Lidhur me çështjet e tjera të kërkuara për raportim, nga Kryetarët është informuar se në gjykatat respektive nuk ka patur probleme të disiplinës në punë, me përjashtim të një rasti në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Përmet. Në këtë Gjykatë, u verifikua mosparaqitja në detyrë e dy gjyqtareve, por meqë rasti ishte i izoluar, u procedua me tërheqjen e vëmendjes me shkrim ndaj tyre.

Nuk është raportuar ndonjë problematikë në lidhje me respektimin e normave të etikës gjyqësore me palët pjesëmarrëse dhe me kolegët e titullarin e gjykatës, as në lidhje me zbatimin e vendimit të KLD-së “Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit” dhe as për vonesa të mundshme në fillimin e seancave gjyqësore. Prej Kryetarëve herë pas here janë raportuar problematika të tjera mbi infrastrukturën e gjykatave apo mbi stafin administrativ. Këto shqetësime, të cilat janë vlerësuar se nuk kanë qënë në kompetencë të KLD, në parimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, i janë përcjellë për trajtim institucionit përkatës si Ministrisë së Drejtësisë, ZABGJ dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Përgjithësisht, institucionet e treta janë përgjigjur pozitivisht kërkesave të KLD-së, duke raportuar mbi situatën dhe planet për zgjidhjen e tyre.

Për vitin në vijim duhet të merret në analizë, ndër të tjera edhe saktësia e informacionit të paraqitur nga kryetarët e gjykatave, i cili ka rezultuar problematik në dy raste: (i) në një pjesë të verifikimeve janë identifikuar gabime materiale të këtij informacioni; dhe (ii) me rastin e inspektimit tematik mbi mësimdhënien është konstatuar pasaktësi e këtij informacioni në një numër të ulët rastesh.

VII. VENDIMET E CENUARA

Sipas nenit 16 pika 3 të ligjit nr. 8811/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së", i ndryshuar, IKLD kryen detyra të tjera, të caktuara nga KLD. Këshilli me vendimin nr. 262/4, datë 24.04.2010, ka disponuar:

"Ngarkohet Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për ndjekjen në vazhdimësi të vendimeve të cënuara të gjyqtarëve të gjykatave të shkallëve të para dhe të apeleve, si edhe për pasqyrimin në mënyrë periodike të shkaqeve të cënimit të vendimeve nga gjykatat më të larta, duke i kushtuar vëmendje të veçantë vendimeve të prishura si pasojë e shkeljes së dispozitave urdhëruese procedurale apo për moszbatim të vendimit unifikues dhe vendimeve të tjera të Gjykatës së Lartë, kur sipas kodeve të procedurave, janë të detyrueshme."

Për realizimin e kësaj detyre, IKLD gjatë vitit 2013 ka trajtuar 421 vendime gjyqësore të cënuara të dhëna në vitet 2012-2013, duke analizuar shkaqet e cenimit dhe duke proceduar me verifikimin e 35 rasteve. Për vlerësimin paraprak të këtyre rasteve është ngarkuar posaçërisht inspektorja Sofie Zhilla.

Nr	Gjykata	Nr.Vend	V.Unifikues	Arsyetim	Disp proc.	Të tjera	Verifikim
1	Apeli Tiranë	-	-	-	-	-	-
2	Gj.Rr.Dibër	-	-	-	-	-	-
3	Gj.Rr.Krujë	8	1	0	0	7	1
4	Gj.Rr.Kurbin	6	0	0	0	6	0
5	Gj.Rr.Mat	3	0	0	0	3	0
6	Gj.Rr.Tiranë	40	7	0	0	33	7
7	Apeli Durrës	-	-	-	-	-	-
8	Gj.Rr.Elbasan	1	0	0	0	1	0
9	Gj.Rr.Durrës	-	-	-	-	-	-
10	Gj.Rr.Kavajë	2	1	0	0	1	1
11	Apeli Shkodër	-	-	-	-	-	-
12	Gj.Rr.Gj.Lezhë	2	1	0	0	1	1
13	Gj.Rr.Gj.Kukës	1	0	0	0	1	0
14	Gj.Rr.Pukë	-	-	-	-	-	-
15	Gj.Rr.Gj. Shkodër	4	1	0	0	3	1
16	Gj.Rr.Gj.Tropojë	1	0	0	0	1	0
17	Apeli Vlorë	-	-	-	-	-	-
18	Gj.Rr.Gj.Berat	34	0	0	0	34	0
19	Gj.Rr.Gj.Fier	53	3	3	1	46	7
20	Gj.Rr.Gj.Lushnjë	25	0	0	0	25	0
21	Gj.Rr.Gj.Vlorë	108	6	3	2	97	11
22	Apeli Korçë	-	-	-	-	-	-
23	Gj.Rr.Gj.Pogradec	3	0	0	0	3	0
24	Gj.Rr.Gj.Korçë	1	0	0	0	1	0
25	Apeli Gjirokastrë	-	-	-	-	-	-
26	Gj.Rr.Përmet	-	-	-	-	-	-
27	Gj.Rr.Gj.Sarandë	1	1	0	0	0	1
28	Gj.Rr.Gjirokastrë	2	0	0	0	2	0
29	Ap.Krime Rënda	2	2	0	0	0	2
30	Shk.I Kr të Rënda	43	5	0	0	38	5
Gjithsej		232	27	6	3	196	37

Lidhur me verifikimin e 37 rasteve janë këto rezultate:

- 2 gjyqtarëve i është tërhequr vëmendja me shkrim bazuar në nënin 34 pika 2 të Rregullores së IKLD-së;
- 5 gjyqtarëve, rezultatet e verifikimit iu janë regjistruar për efekte të vlerësimit profesional;
- 1 gjyqtar, është në verifikim në vijim, gjer në përfundimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë.
- 7 vendime të cenuara janë verifikuar dhe janë në fazën e përpunimit të relacionit mbi rezultatet e verifikimit.

VIII. PËRFAQËSIMET NË GJYKATA

Me vendimin nr. 323, datë 0305.2013 “Mbi autorizimin e përfaqësimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në gjykatë”, KLD mbështetur në ligjin nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i ndryshuar autorizoi zëvendëskryetarin e KLD që të caktojë personat, të cilët do të përfaqësojnë Këshillin në gjykata. Gjatë vitit 2013 IKLD ka ndjekur dhe ka përfaqësuar KLD në 10 çështje gjyqësore, asnjë prej të cilave nuk është ngritur/paraqitur në gjykatë nga KLD.

Në 1 çështje gjyqësore, KLD ka qenë në cilësinë e subjektit të interesuar në një gjykim për proces të parregullt ligjor pranë Gjykatës Kushtetuese; në 2 çështje është thirrur si i paditur në gjykime administrative të juridiksionit fillestar në Kolegje të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ndërsa në 7 çështje gjyqësore në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Deri në kohën e përpilimit të këtij Raporti Vjetor, janë dhënë 8 vendime gjyqësore në favor të KLD-së, 1 vendim është dhënë kundër KLD-së, ndërsa 1 vendim ende nuk është shpallur.

Lidhur me lëndën e gjykimit rezulton se në 1 çështje gjyqësore, paditësi ka kërkuar të konstatohet cenimi i procesit të rregullt ligjor; në 1 çështje gjyqësore, gjyqtari ka kundërshtuar vendimin e KLD-së për shkarkimin e tij nga detyra; në 1 çështje gjyqësore, paditësi ka kërkuar rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë mbi padinë e tij për kundërshtimin e vendimit të KLD-së për shkarkimin e tij nga detyra e gjyqtarit; në 4 çështje gjyqësore gjyqtarët kanë kundërshtuar aktet e vlerësimit profesional dhe etik; në 1 rast, paditësi ka kërkuar detyrimin e KLD-së për emërimin e tij gjyqtar; në 1 çështje gjyqësore, paditësi ka kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ për shpërblimin e dëmit; dhe në 2 çështje gjyqësore, gjyqtarët kanë kundërshtuar vendimet e KLD-së për dhënien e masave disiplinore “vërejtje me paralajmërim”. Të dhënat më të detajuara paraqiten si më poshtë:

1. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës Kushtetuese që i përket kërkuarit Kudret Kopo me subjekt të interesuar KLD dhe Zyra e Shërbimit Përmbarimor Bailiff Service Albania, me objekt “Konstatim i cenimit të parimit për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm”. Përfaqësimi i KLD-së është realizuar nga kryeinspektorja Marsida Xhaferllari. Gjykata Kushtetuese nuk është shprehur ende me vendim mbi këtë kërkesë.
2. Çështja gjyqësore pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që i përket kërkuarit Neritan Tabaku dhe personit të interesuar Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Kundërshtim i vendimit nr. 301/2, datë 07.12.2012 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë për shkarkimin e tij nga detyra”. Përfaqësimi i KLD-së është realizuar nga kryeinspektorja Marsida Xhaferllari dhe inspektorja Vojsava Osmanaj. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 5, datë 12.12.2013 vendosën “Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Neritan Tabaku si të pabazuar në ligj”.
3. Çështja gjyqësore pranë Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që i përket kërkuarit Agim Hysi dhe personit të interesuar Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Rishikim i vendimit gjyqësor të formës së prerë për rrëzimin e padisë me objekt

kundërshtim i vendimit të KLD-së për shkarkimin nga detyra”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje u realizua nga kryeinspektorja Marsida Xhaferllari dhe inspektori Arjan Balliu. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin e datës 17.06.2013 vendosën “Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj”.

4. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit Kreshnik Spahiu kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Shfuqizim akti administrativ për shpërblimin e dëmit”. Përfaqësimi në gjykatë u realizua nga inspektorët Vojsava Osmanaj dhe Sofia Zhilla. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë në përfundim të gjykimit të kësaj padie me vendimin gjyqësor nr. 7901 datë 09.07.2013 ka vendosur “Rrëzimin e kërkesë padisë së paditësit Kreshnik Spahiu”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit Tiranë për gjykim, bazuar në apelin e paditësit.
5. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit Agron Lamaj kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Shfuqizim i vendimit nr. 302, datë 05.07.2013 të K.L.D, konstatimi i diskriminimit i interesave dhe të drejtave themelore dhe detyrimi i palës së paditur të marrë vendim për emërimin tim si gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje u realizua nga inspektorët Vojsava Osmanaj dhe Marsela Pepi. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 12030, datë 02.12.2013 ka vendosur: “Kthimin e kërkesë padisë dhe akteve bashkangjitur saj palës paditëse Agron Lamaj, si padi me të meta”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit Tiranë për gjykim, bazuar në apelin e paditësit.
6. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që i përket paditësit gjyqtar Bujar Musta kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Ndryshim i pikës 18 të vendimit nr. 282, dt. 16.12.2011 të të paditurit dhe të vendoset vlerësimi Shumë Mirë për vitet 2005-2006”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje u realizua nga inspektorët Arjan Balliu dhe Sofia Zhilla. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 4112, datë 17.04.2013 ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesë padisë si të pabazuar në ligj”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë për gjykim, bazuar në apelin e paditësit.
7. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, që i përket paditësit gjyqtar Ahmet Jangulli, kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Pezullimin e zbatimit të pikës 4 gërma d) të vendimit nr 304 datë 14.02.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për vlerësimin profesional “Mirë” për periudhën 2005-2006 etj”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje është realizuar nga inspektorët Arjan Balliu dhe Sofia Zhilla. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 4112, datë 17.04.2013 ka vendosur: “Rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë për gjykim, bazuar në ankimin e paditësit.
8. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, që i përket paditëses gjyqtarja Arjana Liço kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Shfuqizimin e vendimit nr. 326/25, datë 03.05.2013 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mbi vlerësimin përfundimtar “Mirë” të gjyqtarës Arjana Lico për periudhën 2005-2006”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje është realizuar nga inspektorët Arjan Balliu dhe

Vojsava Osmanaj. Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin gjyqësor të datës 30.01.2014 ka vendosur: “Pushimin e gjykimit të kësaj çështje civile” për shkak të heqjes dorë nga gjykimi të paditëses.

9. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket paditëses Mimoza Margjeka kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “anullimin e vendimit nr 299/4 datë 30.11.2012 të KLD-së për dhënien e masës disiplinore ‘vërejtje me paralajmërim ndaj gjyqtares Mimoza Margjeka të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje u realizua nga inspektori Izet Salaj. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 53, datë 14.06.2013 ka vendosur: “Anullimin e vendimit nr. 299/4 datë 30.11.2012 të KLD-së për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” ndaj gjyqtares Mimoza Margjeka. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Lartë për gjykim, bazuar në rekursin e paraqitur të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.
10. Çështja gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, që i përket paditëses Dhurata Bilo kundër të paditurit Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me objekt “Anullim i vendimit nr. 295/2, datë 05.10.2012 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Përfaqësimi në gjykatë për këtë çështje u realizua nga inspektori Izet Salaj. Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 14, datë 04.02.2013 ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesë padisë së paditëses Dhurata Bilo”. Aktualisht kjo çështje ndodhet në Gjykatën e Lartë për gjykim, bazuar në rekursin e paditëses.

IX. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONE TË TJERA

- Bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë

Për zgjidhjen e mbivendosjes së kompetencave midis dy inspektorateve, më 5.12.2011 u nënshkrua Memorandumi teknik i Mirëkuptimit “Për harmonizimin e procedurave të inspektimit gjyqësor dhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave”, me asistencën e Misionit Euralius dhe të ekspertëve ndërkombëtarë nga Franca, Italia dhe Spanja. Nga zbatimi i këtij Memorandumi u nxorën disa rekomandime për të përmirësuar koordinimin institucional: (i) kryerja e një analize për reformën legjislative të mundshme që shmang mbivendosjen e inspektimeve të gjyqarëve; (ii) shkëmbimi i informacioneve periodike statistikore mbi ankesat për të shmangur mbivendosjet në inspektime; (iii) botimi dhe shpërndarja e Manualit të inspektimit të gjyqarit; (iv) përmirësimi i rregullave të brendshme të funksionimit të dy inspektorateve. Për vijimin e këtyre proceseve më 13.09.2012 u nënshkrua Memorandumi politik i Mirëkuptimit “Për shmangien e mbivendosjes së kompetencave në inspektimin gjyqësor”. Me të njëjtën asistencë ndërkombëtare, u realizua edhe hartimi dhe botimi i Manualit të Inspektimeve të Sistemit Gjyqësor, i cili tashmë është në duart e inspektorëve si një mjet efikas në përmbushjen e funksioneve kontrolluese.

Për këtë çështje, Raporti i Progresit i vitit 2013 thekson “lidhur me përgjegjshmërinë e gjyqësorit, memorandumi i mirëkuptimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë mbi inspektimeve është zbatuar pa probleme. Megjithatë, përderisa Ligji mbi Këshillin e Lartë të Drejtësisë nuk është ndryshuar, mbetet rreziku i mbivendosjes. Një manual mbi praktikën e mira të inspektimeve është publikuar në fund të vitit 2012 dhe shërbimi i inspektimit të KLD-së është riorganizuar, por duhet të draftohen rregulla të reja inspektimi”. Për adresimin e kësaj çështjeje, mund të përdoren 13 rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë në dokumentin e politikave mbi organizimin dhe funksionimin e IKLD-së.

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit midis KLD dhe MD, nga Ministria e Drejtësisë kanë ardhur për kompetencë pranë IKLD 29 ankesa, të cilat janë trajtuar dhe për çdo rast Ministria e Drejtësisë është vënë në dijeni. Nga ana tjetër, IKLD ka përcjellë drejt Ministrisë së Drejtësisë shqyrtimin e 28 ankesave. Në përcjelljen e këtyre ankesave është mbajtur në konsideratë lënda e ankesës në dy aspekte: (i) kur ankesa përmbante pretendime edhe për operatorë të tjerë të sistemit të drejtësisë (noterë, përmbarues, regjistruar të pasurive të paluajtshme etj); dhe/ose (ii) kur të dhënat tregojnë se Ministria e Drejtësisë kishte filluar verifikimin e ankesës për shkak të paraqitjes më parë të saj tek ky institucion.

Një përvojë e mirë bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë ka qenë edhe zhvillimi i inspektimit tematik të përbashkët për rastin e Pukës (*shih të dhënat në rubrikën e inspektimeve tematike*).

Gjithashtu, duhet evidentuar se çdo muaj IKLD ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë në format elektronik informacion statistikor mbi ankesat e paraqitura. Për shkak të ndryshimeve strukturore në Ministrinë e Drejtësisë, mbetet e nevojshme që ky proces të ndiqet prej tyre me të njëjtin ritëm, duke caktuar një person përgjegjës.

Së fundmi, Manuali i Inspektimeve është përdorur gjerësisht nga inspektorët. Ai përbën një mjet

të mirë njohës me praktikat e mira të inspektimit, sidomos për inspektorët e saporekrutuar në detyrë. Nga ana tjetër, në çdo rast të inspektimit tematik është urdhëruar mbajtja në referencë e këtij Manuali në zhvillimin e inspektimit dhe në hartimin e raporteve.

- *Bashkëpunimi me institucione të tjera*

Gjatë vitit 2013, IKLD është përpjekur të bashkëpunojë me Prokurorinë e Përgjithshme, duke relatuar pranë këtij institucioni jo vetëm ankesat mbi prokurorët, por edhe rastet, në të cilat ankuesit parashtronin fakte për veprime korruptive të gjyqtarëve (gjithsej 3 raste). Po ashtu edhe nga ana e këtij institucioni, janë paraqitur për kompetencë trajtimi disa raste ankesash. IKLD vlerëson se ka nevojë për përmirësimin e këtij bashkëpunimi nëpërmjet krijimit të regjistrave solidë mbi këtë bashkëpunim dhe ndjekjen e rezultateve në vijimësi.

Gjatë vitit 2013, IKLD në 2 raste ankesash ka bashkëpunuar me ILDKP për verifikimin e pretendimeve të ankuesve mbi çështje të pasurisë së dy gjyqtarëve. Nga verifikimi i të dy këtyre rasteve, u konkludua se ankesat ishin të pabazuara. Në vlerësimin e IKLD-së, edhe në këtë drejtim duhet të rritet niveli i bashkëpunimit. Gjithashtu, duhet të vendosen kontakte dhe të krijohet një marrëdhënie e shëndoshë bashkëpunimi edhe me Komisionin e Etikës së Konferencës Gjyqësore Kombëtare. Në këtë mënyrë realizohet përmbushja tërësisht e detyrave të IKLD-së të sanksionuara në nenin 16 të ligjit nr. 8811/2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së” dhe në nenin 21 të IKLD-së.

- *Të tjera*

IKLD gjatë vitit 2013 është ngarkuar edhe me përpunimin e informacionit në funksion të raportimeve të ndryshme në procesin e integritetit europian apo të raportimeve të Republikës së Shqipërisë në organizata ndërkombëtare.

X. BURIMET NJERËZORE DHE ORGANIZIMI

Në zbatim të ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e KLD-së”, i ndryshuar, KLD ka miratuar në vitin 2006 Rregulloren mbi Organizimin dhe Funksionimin e IKLD-së. Kjo Rregullore lejon mundësinë e organizimit të Inspektoratit në seksione. Deri më 20.12.2012, ky organizim i brendshëm nuk ishte kryer. Me vendimin nr. 302/2, datë 20.12.2012 të KLD-së, Inspektoriatu u organizua për herë të parë në dy seksione: atë të vlerësimit profesional dhe etik dhe në seksionin e ankesave dhe të inspektimit. Me të njëjtin vendim, u përcaktua që organika e Inspektoratit të rritet në 1 Kryeinspektor dhe 15 inspektorë, të cilët në veprimtarinë administrative mbështeten edhe nga administrata e KLD-së.

Aktualisht në IKLD ushtrojnë funksionin e tyre Marsida Xhaferllari (kryeinspektore), Izet Salaj (inspektor), Qemal Zaimi (inspektor), Hajrie Muçmata (inspektore), Piro Samara (inspektor), Arjan Qafa (inspektor), Fatbardh Çoniku (inspektor), Zhaneta Pira (inspektore), Dashuri Gjunksi (inspektore), Sofie Zhilla (inspektore), Vojsava Osmanaj (inspektore) dhe Marsela Pepi (inspektore). Kryeinspektorja dhe 3 inspektorët e fundit kanë filluar mandatin e tyre në vitin 2013. Përgjatë vitit 2013 janë larguar nga IKLD kryeinspektorja Valbona Vata, e emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit Shkodër me dekretin nr. 7929, datë 18.01.2013 të Presidentit të Republikës, inspektori Selim Kryeziu, i emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Shkodër me dekretin nr. 8181, datë 17.05.2013 të Presidentit të Republikës, inspektori Arjan Balliu, i emëruar gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës me dekretin nr. 8362, datë 21.10.2013 të Presidentit të Republikës dhe gjyqtarja Alma Hicka, e emëruar Avokate e Përgjithshme e Shtetit, me leje të KLD-së sipas vendimit nr. 411, datë 16.12.2013. Aktualisht ka 4 vende vakante në IKLD.

Situata e organizimit dhe funksionimit të IKLD është marrë në analizë nga një grup pune gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2013, i cili prodhoi një projektpolitikë me 13 rekomandime. Në hartimin e këtij dokumenti analitik, nën kujdesin e Zëvendëskryetarit të KLD-së, u përfshinë Kryeinspektorja dhe inspektorët e Inspektoratit të KLD-së, ekspertë të Misionit Euralius, ekspertë francezë dhe italianë. Ai paraqiti 13 rekomandime, të cilat janë konsultuar edhe në një tryezë publike me anëtarë të KLD-së dhe gjyqtarë.

Në mbështetje të këtij dokumenti, në periudhën në vijim ka vend për përmirësim të statusit të inspektorëve, që mendohet të rrisë kërkesat e gjyqtarëve për të shërbyer në IKLD. Ligji sanksionon vetëm përfitimin e pagës së njëjtë të inspektorit me gjyqtarin e Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe garancinë e inspektorit për t’u kthyer në gjyqësor pas mbarimit të mandatit. Rregullat e qarta mbi përcaktimin e gjykatës së kthimit dhe mbi avantazhet e inspektorëve ndaj kandidatëve të tjerë mungojnë. Me ligjin nr. 114/2013, datë 11.04.2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9877, datë 18.02.2008 ‘Për organizimin e pushtetit gjyqësor në RSh’”, paga e inspektorit u rrit me 3.6 % në raport me pagën e mëparshme (nga 70 % e pagës së gjyqtarit të Gjykatës së Lartë në 75 %). Kjo rritje e pagës u bë efektive më 01.01.2014.

Gjithashtu, ka ardhur koha për të përcaktuar kriteret e qarta, procedura efektive dhe një skemë garantiste në drejtim të statusit për inspektorët, duke përfshirë edhe vlerësimin profesional të tyre. Procesi i vlerësimit duhet të jetë gradual dhe të mbështetet në monitorimin në vijimësi të performancës së çdo inspektori. Përsa i përket procedimit disiplinor të inspektorëve, Rregullorja në nenet 9-16 duket se përmban parashikime të qarta dhe të plota. Megjithatë, duhet analizuar

nevoja për një Kod Etike të posaçëm për inspektorët.

Gjithashtu, mungojnë rregullat për trajnimin fillestar dhe trajnimin vazhdues të inspektorëve, që është me ndikim në cilësinë e punës së tyre. Një inspektor i rekrutuar për herë të parë ka nevojë të kuptojë thelbin e punës së inspektorit, ndërsa inspektorët në detyrë kanë nevojë për të përditësuar njohuritë e tyre mbi zhvillimet legjislative të shpeshta dhe doktrinare. Gjatë vitit 2013, inspektorët e IKLD kanë marrë pjesë për shkak detyre në 4 aktivitete trajnuese “Aftësimi në zbatimin e legjislacionit për barazinë gjinore për profesionet e tjera ligjore, duke përfshirë inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë dhe të KLD-së” më 7-8 maj 2013, “Përmirësimi i aksesit në drejtësi dhe në të drejtat e fëmijëve” më 28-29 tetor 2013, “Simpozium mbi Etikën Gjyqësore. Strategji për të përmirësuar performancën gjyqësore dhe për të rritur besimin publik tek gjyqësori” më 5-7 nëntor 2013 dhe “Lufta kundër terrorizmit – Standardet e BE-së, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe eksperiencat e vendeve anëtare” në dhjetor 2013.

Veprimtaria e kryer nga IKLD është me natyrë administrative dhe nuk duhet ngatërruar me statusin dhe pagën e tij të referuar tek gjyqtari i gjykatës së apelit. Inspektorati, në cilësinë e një organi administrativ ka përgjegjësi zyrtare jo thjesht për dhënien e një vendimi në një rast të izoluar; ai ka përgjegjësi për zhvillimin e një politike konsistente të zbatimit të ligjit përgjatë gjithë procesit. Organi administrativ, në ndryshim nga gjykata, nuk mund t'i shpëtojë përgjegjësisë për një administrim të pabarabartë të drejtësisë duke pretenduar që ka vendosur mirë në çdo rast të veçantë që iu paraqit në varësi të provave të paraqitura nga palët. Kjo do të thotë që organi administrativ ka përgjegjësinë jo vetëm për të vendosur në raste të veçanta, por edhe për ndjekjen e një politike konsistente me referencë tek të gjitha çështjet e zgjidhura prej tij. Nga ana tjetër, proceset e punës në përgjegjësi të IKLD-së, ashtu si në çdo organ tjetër administrativ kërkojnë procedura fleksibël dhe të zhdërvjellta. Si rezultat, produkti apo vendimmarrja e IKLD-së, si një organ administrativ është shumë më i shpejtë se sa ai i sistemit gjyqësor.

Hierarkia dhe natyra administrative e punës synon organizimin uniform të punës dhe nxjerrjen e një akti administrativ përfundimtar të përpunuar dhe të analizuar në shkallë hierarkike. Përcaktimi i rregullave të qarta administrative që sigurojnë hierarkinë është një nevojë për të konsoliduar produktin e punës si rezultat i marrëdhënieve të qarta të punës midis inspektorëve, kryeinspektore, Zëvendëskryetarit të KLD-së dhe KLD-së. Paraqitja formale e akteve që prodhon IKLD ka nevojë të përmirësohet përmes standardizimit të akteve të verifikimit, të raporteve të inspektimit dhe të akteve të vlerësimit profesional të gjyqtarëve. Për këtë qëllim, në vitin 2013 janë bërë përpjekje për standardizimin formal të raporteve që përpilohen nga inspektorët, me referencë tek Manuali i Inspektiveve.

Së fundmi, duhet që proceset e punës në Inspektorat të dixhitalizohen për të lehtësuar krijimin e regjistrave solidë të të dhënave mbi ankesat e paraqitura, mbi vlerësimet e kryera dhe mbi inspektimet e zhvilluara. Mbajtja solide e këtyre të dhënave i shërben edhe analizimit të tyre dhe formulimit të politikave të përshtatshme.

Kryeinspektore

Marsida Xhaferllari